



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 12/09/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Reagente dhe Materiale Laboatorike

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

MALLRA, Kodet CVP: - 33696500-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 13,291,318 Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Instituti i Mjekësisë Ligjore**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë ekstraktin tregetar të rregjistrimit në QKB ku të ketë objekt të veprimtarisë objektin e kontratës.

Kjo pikë përmbushet sipas pikes 1/a të Kriteve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 44, pika 1, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet

që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente..

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve, sigurinë e informacionit gjatë zhvillimit, gjatë instalimit e konfigurimit dhe gjatë mirëmbajtjes, dhe në lidhje me menaxhimin, kuptimin dhe përkthimin e proceseve të biznesit në procese IT.

- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën **ISO 14001:2015** mbi “Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga nje organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. **Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

Argumentimi: Ky kriter u vendosë në përputhje me parashikimin e nenit 79, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 44, pika 1, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci më tepër për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve, sigurinë e informacionit gjatë zhvillimit, gjatë instalimit e konfigurimit dhe gjatë mirëmbajtjes, dhe në lidhje me menaxhimin, kuptimin dhe përkthimin e proceseve të biznesit në procese IT.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2021, 2022, 2023**) ku vlera mesatare e të paktën njërit prej tyre të jetë **sa vlera e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, të vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim teëtitj. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

- b) Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: **(2021, 2022, 2023)** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.3. Kapaciteti teknik:

- a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **sa 40% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**
- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedurë prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë sa 40 % e fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit

të kontratës, dhe në këtë mënyrë AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

- b) Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje ose skeda teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (*pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (**të markuara sipas artikullit**) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë në formë tabelle, ku të plotësohet emri i kompanisë prodhuese, vendi i ushtrimit të aktivitetit dhe origjina e mallit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- d) Operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i skadencës në momentin e dorëzimit, për artikuj që e kanë jetëgjatësinë me pak se një vit është jo me pak se 2/3 e afatit të skadencës.

Argumentimi: Kërkesa për garantimin që artikujt që e kanë jetëgjatësinë me pak se një vit është jo më pak se 2/3 e afatit të skadencës shërben për mbarëvajtjen e vendosjes së tyre në proces pune. Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, ku deklaron se merr përsipër transportin e artikujve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe afatet e lëvrimin.

Argumentimi: Kërkesa për garantimin që artikujt që e kanë jetëgjatësinë me pak se një vit është jo me pak se 2/3 e afatit të skadencës shërben për mbarëvajtjen e vendosjes së tyre në proces pune.

Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertave të gjithë mostrat për zërat e kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit. Në rastin e përsëritjes së artikujve në lista mjafton 1 (një) mostër për artikull.

Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentat e tenderit përbën kusht skualifikues.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor mund t’ju kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojë dëshmi që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa për paraqitjen e mostrave është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të përcaktojë kritere të vecanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat janë të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës dhe që nuk bien ndesh me ligjin për prokurimin publik. Synimi bazë i Autoritetit Kontraktor është të vërtetojë që subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. Për shkak të natyrës së vecantë të mallrave që do të prokurohen verifikimi i përputhshmërisë mostër-pajisje është thelbësor për arritjen e qëllimit. Procedura e prokurimit për blerje reagentesh dhe materiale laboratorike përbën një kontratë me rëndësi të veçantë për Institutin e Mjekësisë Ligjore, kështu që është e domosdoshme që disa prej artikujve të testohen paraprakisht për të siguruar AK, që edhe mallrat ekuivalente të jenë të përputhshme me pajisjet e laboratorit të IML duke siguruar saktësi maksimale të rezultateve të analizave ligjore.

Pra paraqitja e mostrave është e nevojshme për të vërtetuar aftësinë e OE për të siguruar produktet e kërkuara për realizimin e plotë të kontratës, pasi mosrealizimi i kontratës, qoftë edhe mossigurimi i një produkti, do të sillte pasoja në veprimtarinë e IML në realizimin e misionit të tij.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhenë nenin 40, pika 6/a dhe pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.